



## KUVENDI I KOMUNËS OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në pajtim me nenin 12, paragrafi, 12.2 pika c dhe nenin 17 pika f,, nenin 40.2 pika a dhe g të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenet 15 paragrafi 7 dhe 34 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L – 60, për Mbeturina, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 Për Mbeturina, në nenin 8 pika a, nenin 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 37 paragrafi 1.6, nenin 38 paragrafi 1.3, nenin 44 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 datë 25.04.2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2026 , miratoi:

### **RREGULLORE NR. 02 /2026 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 03/2024 TË PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 03/2024, me të cilën është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja bazë Nr. 02/2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Obiliqit, me synim qartësimin e autorizimeve për faturim dhe inkasim, rregullimin e marrëdhënieve detyrimore.

#### **Neni 2 Përjashtimet**

Neni 5 par. 1 pika c i Rregullores Nr. 03/2024 ndryshohet si në vijim: c. Llumi/balta dhe mbeturina të ngjashme fshihet në tërësi nga rregullorja.

### **Neni 3**

#### **Përgjegjësitë e komunës**

Neni 6 i Rregullores Nr. 03/2024 ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim: “15. Tarifën për mbeturina e cakton Komuna me këtë rregullore. Faturimin dhe inkasimin si për ekonomitë familjare, ashtu dhe për bizneset, institucionet publike, OJQ-të dhe institucionet e tjera e bënë ekskluzivisht Operatori Ekonomik i ngarkuar për kryerjen e shërbimit.”

### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave**

1. Në nenin 8 të Rregullores Bazë, pas paragrafit 11, shtohen tre (3) paragrafë të rinj si në vijim:
  12. Detyrimi për pagesën e tarifës së mbeturinave lind automatikisht nga momenti i ofrimit të shërbimit në zonën kadastrale përkatëse, nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve, dhe fillimit të hedhjes së mbeturinave nga gjeneruesi (veprim konkludent), i cili detyrim rrjedh nga neni 34 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.
  13. Mungesa e një kontrate të shkruar individuale ndërmjet gjeneruesit të mbeturinave dhe Operatorit nuk e liron gjeneruesin nga detyrimi ligjor për pagesën e tarifës mujore të miratuar nga Kuvendi Komunal. (Parimi ndotësi pagan)
  14. Operatori Ekonomik duhet të bëjë lidhjen e kontratave individuale me kategoritë e gjeneruesve komercialë dhe institucionalë, por pavarësisht kësaj, rregulli i përcaktuar në paragrafin 13 të këtij neni, vlen për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave.”

### **Neni 5**

#### **Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave**

1. Neni 9 par. 1, dhe pika a, ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim: 1. Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:
  - 1.1 Kategoritë e amvisërive ndahen në nën kategoritë si në vijim:
    - 1.1.1 Familjet rezidente;
    - 1.1.2 Familjet jo rezidente nga diaspora.
2. Neni 9, pika b, ii nga nënkategoria e dytë fshihen tekstet si në vijim:
  - 2.1 Zyra të partive politike.
  - 2.2 Objekte fetare të vogla.
3. Neni 9, pika b, iii tek nënkategoria e tretë shtohet teksti si në vijim: Ndërmarrjet Publike.
4. Neni 9, pika b, iii fshihet teksti si në vijim: Qendrat sportive.
5. Neni 9, pika c, ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim: 3. Kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave që rrjedhin nga institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera përfshijnë:
  - 3.1 Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit që përfshijnë: Zyrën e punësimit, AMF, zyrat e partive politike, bashkësitë fetare dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

**3.2** Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit që përfshijnë: Institucionet parashkollore, Shkollat fillore, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Stacionet Policore, Shkollat e mesme, objektet sportive, Zyrat e vendit dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

## Neni 6

### Tarifa për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave

1. Neni 10 nën par. 1.2.1 ndryshohet me fjalët si në vijim: Nën kategoria e parë: Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese do të paguajnë tarifë fikse prej 7.00 euro në muaj.
2. Neni 10 nën par. 1.2.5 tek pjesa e nënkategorisë së pestë shuma prej 36.8 euro për një zbrazje për kontejnerë 7m<sup>3</sup>, kalon në vlerën prej 50.00 euro.
3. Neni 10 nën par. 1.3 ndryshohet, riformulohet dhe shtohen dy (2) nën paragrafë të veçantë me tekstin si në vijim:
  - 1.3 Kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave që rrjedhin nga institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera do të paguajnë këto tarifa:
    - 1.3.1 Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifën fikse prej 9.20 euro në muaj.
    - 1.3.2 Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të mesme dhe të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej 12.0 euro për një zbrazje për kontejnerë 1.1 m<sup>3</sup>, dhe 50.00 euro për zbrazje për kontejnerë 7m<sup>3</sup>.

## Neni 7

### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

  
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**  
  
Sami Ahmeti